LIGJ
Nr.7682, datë 9.3.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.6299, datë 27.3.1981 "Për familjen" bëhen këto ndryshime:

- Në nenin 2 fjalët "këshillat popullorë ose komitetet ekzekutive të tyre" zëvendësohen me fjalët "organet e pushtetit lokal" dhe fjalët "organet e punëve të brendshme" zëvendësohen me fjalët "organet e rendit".

- Në nenin 3 paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Propozimet për falje që bëhen nga gjykatat, prokuroritë, organet e rendit dhe organizatat shoqërore, i dërgohen Presidencës nëpërmjet organit të tyre qendror, kurse ato të organeve të pushtetit lokal dërgohen drejtpërdrejt prej tyre".

- Në nenet 1, 2, 3, 4 e 5 fjalët "Presidiumi i Kuvendit Popullor" zëvendësohen me fjalët "Presidenti i Republikës".

Neni 2

Në kodin e familjes bëhen këto ndryshime:

Në nent 16 e 17 fjalët "këshilli popullor" zëvendësohen me fjalët "organi i pushtetit lokal".

Paragarfi i parë i nenit 18 ndryshohet si vijon:

"Në lidhjen e martesës merr pjesë një anëtar i këshillit të komunës a të bashkisë, ose një person i ngarkuar nga kryetari i komunës a bashkisë".

Në nenin 18, paragrafi i dytë, në nenet 19 dhe 20 fjalët "anëtari i këshillit popullor" zëvendësohen me fjalët "anëtari i këshillit të komunës a të bashkisë, ose personi i ngarkuar nga kryetari i komunës a i bashkisë" dhe në nenin 20, paragrafi i dytë dhe i tretë, fjalët "këshilli popullor" e "i këshillit popullor" zëvendësohen me fjalët "kryetari i komunës ose i i bashkisë".

Neni 104 formulohet si vijon:

"Detyrat e kujdestarisë kryhen nga këshilli i kujdestarisë që krijohen në çdo komunë e bashki, miratohet nga këshilli përkatës i këtyre të fundit, përbëhet nga 5-7 anëtarë, kryesohet nga një anëtar i këshillit të komunës ose bashkisë dhe në përbërjen e tij përfshihen arsimtarë, juristë, mjekë etj.".

Në nenin 114 fjalët "komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit" zëvendësohen me fjalët "kryetari i komunës ose i bashkisë".

Neni 3

Në ligjin 5840, datë 20.2.1979 "Për regjistrimin e akteve të gjendjes civile", bëhen këto ndryshime:

Në nenet 6, 16, 26 e 29 fjalët "kryetarit ose sekretarit të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të qytetit, të lagjes së qytetit për Tiranën ose të kryetarit a sekretarit të këshillit popullor të fshatit të bashkuar" zëvendësohen me fjalët "kryetari i komunës ose i bashkisë, ose personave të autorizuar prej tyre".

Në nenin 12, paragrafi i tretë, dhe në nenin 13 fjalët "kryetari i këshillit popullor ose anëtari i caktuar i këshillit popullor të fshatit" zëvendësohen me fjalët "kryeplaku (kryetari i fshatit)".

Neni 21 ndryshohet si vijon:

"Çdo shtetas ka të drejtë të kërkojë ndërrimin e emrit ose të mbiemrit. Kërkesa i paraqitet këshillit të komunës ose të bashkisë, duke i treguar edhe shkaqet për ndërrimin e emrit ose të mbiemrit, si dhe emrin ose mbiemrin që ka zgjedhur.

Vendimi për ndërrimin e emrit ose mbiemrit merret mga këshilli i komunës a bashkisë dhe i dërgohet zyrës së gjendjes civile përkatëse, e cila bën ndryshimet e nevojshme në regjistrin themeltar të shtetasve dhe brenda 10 ditëve njofton degën ushtarake dhe zyrën e gjendjes gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë".

Në nenin 27, paragrafi i parë dhe i dytë, fjalët "Komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit" zëvendësohen me fjalët "Kryesia e këshillit të rrethit".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.491, datë 16.3.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.